

**PLANI PARAPRAK I VEPRIMIT PËR  
REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË  
BASHKINË HIMARË**

**Publikuar nga:**

**Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe**

**Territorit**

**Milieukontakt Shqipëri**

**Gjelbërimi 2000**

**Autori: Mevis Struga**

**Datë: Tetor 2022**

**Kontakt: [info@etmi-al.org](mailto:info@etmi-al.org)**

**Adresa: Sheshi “Avni Rustemi”, Pallati “Teuta Konstruktion”, Tiranë**



---

*“Ky botim u realizua me mbështetjen e Lëviz Albania. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Lëviz Albania”.*

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

## TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje .....	5
1.1. Objektivi dhe qëllimi i Planit të Veprimit .....	5
2. PROFILI I BASHKISË HIMARË.....	7
2.1. Pozita gjeografike .....	7
2.2. Të dhëna demografike .....	7
2.3. Zhvillimi ekonomik.....	8
3. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK PËR MONITORIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS .....	9
3.1. Kuadri ligjor dhe politik per monitorimin e zhurmes ne mjedis ne BE.....	9
3.2. Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në Shqipëri .....	11
Tabela 2: Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të brendshme dhe të jashtme .....	13
3.3. Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis (PKVMZM).....	14
3.1.1 Qëllimi Planit Kombëtar të Veprimit .....	14
3.1.2 Objektiva kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit .....	14
3.4. Strukturat kryesore përgjegjëse për administrimin e zhurmës në mjedis .....	15
3.5. Roli dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore në menaxhimin e zhurmave .....	15
4. METODOLOGJIA MBI IDENTIFIKIMIN DHE MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË HIMARË .....	16
4.1 Hapat per identifikimin e zonave problematike ne bashkine Himarë. ....	17
4.1.1 Hulumtimi mbi perceptimin e komuniteteve lokale, bizneseve dhe pushtetit vendor mbi nivelin e zhurmave.....	17
4.1.2 Realizimi i takimeve me grupe nga komunitetet lokale dhe bizneset për të kuptuar problematikat që lidhen me zhurmat.....	17
4.2 Metodologjia e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare.....	18
5. PERCEPTIMI QYTETAR MBI NIVELIN E ZHURMAVE NE BASHKINË HIMARË.....	20
5.1 Rezultatet nga pyetësorët e zhvilluar me qytetarët në Bashkinë Himarë .....	20
5.2 Rezultatet nga workshopet e zhvilluara me grupet e interesit .....	21
6. VLERËSIMI I NIVELIT TË ZHURMAVE DHE HARTËZIMI I TYRE NË BASHKINË HIMARË	23
6.1. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2022.....	23
6.2. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2022.....	25
7. KONKLUZIONE .....	27
8. MASAT E PROPOZUARA PËR ELEMENIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS.....	28

9.	ANEKS I. HARTAT E ZHURMAVE PËR BASHKINË HIMARË .....	30
10.	ANEKS II. STACIONET E MONITORIMIT PËR BASHKINË HIMARË .....	34
11.	ANEKS III. PAJISJA E PËRDORUR PËR MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË HIMARË .....	35

## **Lista e figurave**

<b>Figura 1:</b>	Bashkia Himarë.....	7
<b>Figura 2:</b>	Skema e metodologjisë së zbatuar për identifikimin dhe monitorimin e zhurmave.....	16
<b>Figura 3:</b>	Foto gjatë plotësimit të pyetësorëve në bashkinë Himarë .....	17
<b>Figura 4:</b>	Foto gjatë takimeve në bashkinë Himarë.....	18
<b>Figura 5:</b>	Skema e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare .....	19
<b>Figura 6:</b>	Harta e zonave të evidetuara si problematike për nivelet e zhurmave në Bashkinë Himarë .....	22
<b>Figura 7:</b>	Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2022) .....	23
<b>Figura 8:</b>	Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2022) .....	24
<b>Figura 9:</b>	Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2022) .....	25
<b>Figura 10:</b>	Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2022.....	26

## **Lista e tabelave**

<b>Tabela 1:</b>	Akte normative në lidhje me zhurmat në mjedise urbane .....	12
<b>Tabela 2:</b>	Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të brendshme dhe të jashtme .....	13
<b>Tabela 2:</b>	Metodologjia e monitorimit të zhurmavë në Bashkinë Himarë .....	19

## 1. HYRJE

Shqipëria ka realizuar monitorimin e zhurmave në disa qytete dhe bashki në linjë me programin kombëtar të monitorimit dhe sipas standarteve të organizatës botërore të shëndetësisë.<sup>1</sup>

Rregullat kryesore për administrimin e zhurmave në mjedis përcaktohen në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”<sup>2</sup>, i ndryshuar me ligjin nr.39/2013, të cilat rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave. Sipas këtij ligji, **organet e qeverisjes vendore** janë autoritetet të cilat duhet të hartojnë dhe zbatojnë planet vendore të veprimit për zhurmën.

Zonat bregdetare janë zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave kryesisht përgjatë sezonit turistik. Ndër zonat bregdetare më të preferuara përgjate sezonit turistik janë ato përgjatë Bashkisë Himarë. Disa nga problematikat kryesore që lidhen me ndotjen akustike në bashki janë: **mungesa e planeve vendore të veprimit mbi zhurmën, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm** të niveleve të zhurmave dhe **e kontroleve të ushtruara** mbi veprimtaritë që gjenerojnë zhurma si dhe mungesa e transparencës nga institucionet përgjegjëse mbi nivelet e zhurmave Duke marrë në konsideratë gjendjen dhe problematikën e ndotjes nga zhurmat, komunitetet përgjatë këtyre zonave janë të pa informuar mbi rolin që ka pushteti vendor në administrimin dhe reduktimin e zhurmave.

Plani i veprimit të zhurmave në mjedis është një dokument ligjor, i cili është ndërtuar në mbështetje të përcaktimeve të **ligjit Nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, i ndryshuar me ligjin Nr.39/2013; Udhëzimit Nr.1037/1, datë 12.4.2011**”për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës mjedisore dhe së fundmi Udhëzimin Nr.1, datë 19/02/20018, “Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”. Mungesa e një plani konkret veprimi/hartëzimi/masa të nivelit të zhurmave nga bashkia ka sjellë një hendek të burimit të informacionit për komunitetet dhe organizatat lokale.

### 1.1. Objektivi dhe qëllimi i Planit të Veprimit

Plani i veprimit për zhurmat ka për qëllim të identifikojë, evitojë, parandalojë dhe zbusë efektet e dëmshme që vijnë për shkak të ekspozimit ndaj zhurmave përgjatë zonës bregdetare në qytetin e Himarës. Nëpërmjet planit paraprak të veprimit synohet të realizohet një analize e situatë aktuale në lidhje me nivelet dhe burimet kryesore të zhurmave në 36 stacione monitorimi në bashkinë e Himarës.

---

<sup>1</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)

<sup>2</sup> <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/Ligji-9774-dt.12.07.07-p%C3%ABr-zhurmat.pdf>

**Objektivat kryesore të këtij plani janë:**

- Zhvillimi dhe aplikimi i një metodologjië alternative që bazohet në angazhimin qytetar dhe monitorimin e zhurmave.
- Vlerësimi i perceptimit qytetar mbi zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave.
- Monitorimi i niveleve të zhurmave në 36 stacione monitorimi përgjatë zonave të identifikuara.
- Konkluzione dhe rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave.

Ky plan paraprak veprimi do të shërbeje për të gjithë aktorët lokalë të Bashkisë Himarë në integrimin e kërkesave specifike të këtij plani në të gjitha çështjet e zhvillimeve vendore të cilat kanë një ndikim direkt me komunitetin. Vlen për tu theksuar që ky plan paraprak veprimi do shërbejë si një material thelbësor për inicimin e zhvillimit të planit final të zhurmave në Bashkinë Himarë.

## 2. PROFILI I BASHKISË HIMARË

### 2.1. Pozita gjeografike

Bashkia Himarë i takon Rrethit të Vlorës, i cili është një nga tre rrethet e këtij Qarku, së bashku me rrethet e Sarandës dhe Delvinës. Bashkia Himarë është një nga katër Bashkitë e Qarkut Vlorë, që përfshin gjithashtu edhe 9 fshatra të tjera. Kjo është Bashkia më jugore e Qarkut Vlorë dhe është fqinje me Komunën e Lukovës në jug, Komuna Vranishtit në lindje dhe Bashkinë e Orikumit në veri.

Bashkia Himarë është e vendosur në mes dy qendrave dinamike urbane: Vlorës në veri, dhe Sarandës në jug. Vlorë është qendra rajonale në aspektin demografik, administrativ dhe atë të punësimit. Saranda është gjithashtu një qendër e rëndësishme urbane e vendit që shtrihet në afërsi të drejtpërdrejtë të kufijve Greko-Shqiptarë dhe karakterizohet kryesisht nga zhvillimi i turizmit. Qyteti i Himarës është një nga shtatë qytetet e Qarkut të Vlorës, dhe përbën një qendër relativisht të rëndësishme urbane. Himara funksionon si një entitet koherent socio-hapësinor, me specifikat e saj historike, gjeografike dhe kulturore që kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e identitetit lokal, në modelet e zhvillimit hapësinor, si dhe në rolin e saj në kontekstin rajonal.



**Figura 1:** Bashkia Himarë

### 2.2. Të dhëna demografike

Rajoni ku shtrihet Bashkia Himarë përgjithësisht ka përjetuar të njëjtat fenomene demografike si i gjithë territori i Shqipërisë pas viteve 90. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar një pjesë e madhe e popullsisë sidomos ajo aktive emigroi për qëllime ekonomike jashtë vendit, kryesisht në Greqi. Ndërsa në fillim të viteve 2000 kemi një stabilizim të ritmeve të emigracionit,

duke sjellë një stabilitet dhe qëndrueshmëri të popullsisë vendase me tendencë rritje për 10 vjecarin 2000/2010. Kështu popullsia residente dhe jo rezidente e të gjitha njësive që përbëjnë Bashkinë Himarë është rritur nga 10,057 banorë në 12,347 në fund të vitit 2010 me një rritje respektive 23% në dhjetë vjet.

Duke ditur se Bashkia Himarë shtrihet në një teritor të përafert me 132 km<sup>2</sup>, si dhe rritjen e popullsisë rezidente të Himarës nga 3.250 në vitin 2001 në 4500 në vitin 2010 atëherë del se dendësia është afërsisht 35 banorë/ 1km<sup>2</sup>. Kjo shifër është pothuajse sa gjysma e dendësisë për Qarkun e Vlorës, prej 71 banorë për 1km<sup>2</sup> dhe shumë e vogël nga ajo në nivel kombëtar prej 111 banorë për km<sup>2</sup>.

### **2.3. Zhvillimi ekonomik**

Tre janë aktivitet kryesore ekonomike që zhvillohen në rajonin e Himarës. Së pari është aktiviteti i shërbimeve turistike, së dyti blegtoria dhe së treti bujqësia e mbështetur tek fruti kulturat. Tradicionalisht ky rajon është i shquar për prodhimin e agrumeve, ullirit, frutave të tjera dhe me pak vreshta, për vetë klimën mesdhetare dhe pozicionin gjeografik. Në vitin 1991 sipërfaqja me drejtim bujqësor e këtij rajoni llogaritet të jetë rreth 2,200 ha. Sot kjo sipërfaqe përdoret në destinacione të tjera duke e kufizuar mjaft sipërfaqen për kultivimin e kulturave bujqësore por edhe pentarisë. Një tjetër drejtim i rëndësishëm për rajonin është ai i blegtorisë, e cila përbën një traditë të hershme të rajonit, e stimuluar kjo edhe nga kullotat që ndodhen në rajonin ku përfshihet rajoni i Himarës.



### 3. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK PËR MONITORIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS

#### 3.1. Kuadri ligjor dhe politik per monitorimin e zhurmes ne mjedis ne BE

Direktivat europiane rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave nga burimet e ndotjes si dhe përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë.

Plani i veprimit sipas direktivave të Bashkimit European ka si kërkesë përgatitjen e hartës të zhurmës. Pas përgatitjes së planeve kombëtare, direktiva parashikon dhe përcakton afate të hartimit të planeve lokale të zhurmave. Hartat e zhurmave përmbajnë më shumë elemente për një zonë të caktuar. Ato japin ngjyra të caktuara dhe të diferencuara zonat ku lejohet apo ndalohet një nivel i caktuar i zhurme.

Një nga objektivat kryesorë të planit është mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga presionet mjedisore. Në mënyrë që të arrihet objektivi kryesor i programit do të jetë e nevojshme:

- të zbatohet një politikë e përmirësuar e zhurmës, e cila të jetë e harmonizuar me njohuritë e fundit shkencore,
- të merren masa për zvogëlimin e zhurmës në burim,
- të përmirësohet planifikimi i qytetit.

**Direktiva 2002/49/EC** në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (Direktiva për Zhurmën e Mjedisit - END<sup>3</sup>) është instrumenti kryesor i BE-së për të identifikuar nivelet e ndotjes së zhurmës dhe për të nxitur veprimet e nevojshme, si në shtetet anëtare dhe në nivel të BE-së.

Direktiva e Zhurmës në Mjedis ka si objektiva kryesorë:

- përcaktimin e ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore nëpërmjet hartëzimit të gjeneruesve të zhurmave me metoda të përbashkëta të vlerësimit të nivelit të zhurmave të shteteve anëtare,
- informimin e publikut në lidhje me nivelin e zhurmave dhe efektet e tij,
- miratimin e planeve të veprimit nga shtetet anëtare të BE-së, bazuar në rezultatet e identifikimit të zonave me nivele të larta të zhurmës, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës mjedisore ku është e nevojshme dhe veçanërisht ku nivelet e ekspozimit mund të nxisin efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut.

Direktiva zbatohet ndaj zhurmës me të cilën njerëzit ekspozohen, veçanërisht në zonat e ndërtuara, në parqe publike, në zona të qeta në vende të hapura, në afërsi të shkollave, spitaleve dhe ndërtesave dhe zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave. Nuk zbatohet për zhurmën e shkaktuar nga vetë personi i ekspozuar, zhurma nga aktivitetet e brendshme, zhurma e krijuar nga fqinjët, zhurma në vendet e punës, ose zhurma brenda mjeteve të transportit ose për shkak të aktiviteteve ushtarake në zonat ushtarake.

---

<sup>3</sup> Environmental Noise Directive

Direktiva kërkon që shtetet anëtare të përgatisin dhe publikojnë, *çdo 5 vjet, hartat e zhurmës dhe planet e veprimit për menaxhimin e zhurmave* për:

- zonat me më shumë se 100,000 banorë
- rrugët kryesore (më shumë se 3 milion automjete në vit)
- hekurudhat kryesore (më shumë se 30,000 trena në vit)
- aeroporte kryesore (më shumë se 50,000 fluturime në vit, duke përfshirë avionë të vegjël dhe helikopterë)

Kur zhvillohen planet e veprimit për menaxhimin e zhurmave, autoritetet e shteteve anëtare duhet të konsultohen me publikun përkatës.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se *Direktiva nuk përcakton vlerat kufizuese ose të synuara, dhe as nuk përcakton masat që duhet të përfshihen në planet e veprimit, duke i lënë këto çështje në dorë të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare.*

Zhurma mjedisore në nivelet e BE-së rregullohet nëpërmjet matjeve në burim të prodhimit të zhurmës, me legjislacionin mbi çështje të tilla si kufijtë e harmonizuar të zhurmës për automjetet, pajisjet e jashtme dhe produktet e tjera të gjenerimit të zhurmave.

Sa i takon fushave të gjenerimit të zhurmave në burim, Bashkimi Evropian ka një kuadër ligjor të mirëpërcaktuar për zhurmat që gjenerohen nga trafiku rrugor, aviacioni, hekurudhat dhe nga pajisjet për përdorim të jashtëm.

Sektorët kryesorë që gjenerojnë zhurma në mjedis, të cilët janë trajtuar njëkohësisht dhe nga direktivat e BE, janë si më poshtë:

1. Transporti (rrugor, ajror, hekurudhor)
2. Aktivitetet e shërbimit social (klubet e nates dhe diskot, bare, restorante);
3. Pajisje dhe makinerite (perpunim metali, prerje metalesh, sharrat, gjeneratore, elektromotorre, kompresore, çekice pneumatike etj.)

Për rastin tonë, për zonat të cilat janë marrë në shqyrtim kemi vetëm dy burimet e para, sepse qyteti është bregdetar dhe është marrë në konsideratë një periudhë të vitit që është sezoni turistik. Ndotja nga zhurmat gjenerohet nga:

1. Transporti (rrugor)
2. Aktivitete të shërbimit social (klubet e natës dhe diskot, bare, restorante);

### **Kërkesat e Direktivave Europiane për zhurmat e gjeneruara nga transporti rrugor**

Kërkesat specifike lidhur me transportin rrugor dhe nivelet e lejuara të zhurmave nga ky transport përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit Evropian për administrimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis (Direktiva 2002/49/EC).

Direktiva europiane për zhurmat dhe veçanërisht për zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit rrugor kërkojnë që plani i veprimit për administrimin mjedisor të zhurmave nga ky sektor të përmbushë një sërë objektivash sic janë:

- Identifikimin e zonave me efekte më të theksuara të zhurmave dhe popullsia e ekspozuar nga këto pika;
- Identifikimin e pikave ku janë ndërtesat e ndjeshme (spitale, shkolla, çerdhe, kopeshite etj.);
- Përcaktimin dhe vlerësimin e masave për reduktimin e zhurmave që shkaktojnë shqetësime ndaj popullsisë;
- Përcaktimi i kostove të nevojshme për këto ndërhyrje.

### **Kërkesat e direktivave të Bashkimit European për zhurmat në klubet e natës dhe diskot, bare, restorante**

Kërkesat e përgjithshme përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit European (DIREKTIVA 2002/49/EC) ndërsa kërkesa specifike ka në direktivat e vecanta (DIREKTIVA 2003/10/EC) që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve të ekspozuar ndaj tyre përfshi këtu dhe personelin që shërben në këto restorante dhe disko.

Në këto dokumente kërkohet që nivelet e zhurmave që gjenerohen nga këto aktivitete të jenë në nivelet e lejuara dhe që nuk shkaktojnë dëmtim të shëndetit të personave të ekspozuar ndaj tyre.

### **3.2. Kuadri ligjor dhe politik për monitorimin e zhurmës në mjedis në Shqipëri**

**Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar me Ligji nr. 39/2013** është kuadri ligjor kryesor ku mbështetet menaxhimi i zhurmave mjedisore. Fokusi kryesor i tij është bashkëpunimi ndër-institucional dhe ngritja e politikave të integruara në menaxhimin e zhurmës. Zbatimi i ligjit ka si qëllim vlerësimin e nivelit të zhurmës në mjedis (kryesisht në mjediset urbane), përcaktimin e uljes të nivelit të zhurmave nga burimet pikësore apo të lëvizshme, hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e tyre, hartimin e hartave, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ngritjen e infrastrukturës e zbatimi i standardeve për monitorimin e zhurmës dhe krijimi i bashkëpunimit midis aktorëve për menaxhimin e zhurmës në mjedis.

**Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** në seksionin dedikuar funksioneve të bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, krahas detyrimit për mbrojtjen në tërësi të komponentëve mjedisorë, edukimin dhe promovimin e mbrojtjes së tyre, shprehet konkretisht në Nenin 26/pika 2 se Bashkia ka si funksion të vetin “*Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike*”.

Për krijimin e një kuadri të plotë ligjor në lidhje me zhurmat e krijuara në mjediset urbane janë hartuar një sërë aktesh nënligjore (Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzime), të paraqitura si më poshtë:

Nr.	Akt nënligjor	Nr. akt	Datë	Emërtimi
1	<b>Vendim Këshillit Ministrave</b>	613	7.9.2011	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”
2		123	17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis
3		587	7.7.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike ( <i>Ndryshuar me Akt Normativ nr. 2/2012</i> )
1	<b>Udhëzime</b>	1	19.2.2018	Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat
2		234	25.5.2015	Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet
3		259	30.7.2012	Për marrjen dhe bashkërendimin e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik, si dhe për marrjen e masave ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe në zonat turistike e bregdetare
4		1037/1	12.4.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
5		8	27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
6		6527	24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre (i ndryshuar me Udhëzim, nr. 12, datë. 15.06.2010)

**Tabela 1:** Akte normative në lidhje me zhurmat në mjedise urbane

Bazuar në tabelën e mësipërme, vërehet se aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara janë shumë të hershme në kohë dhe nuk ka pasur ndryshime të tyre gjatë viteteve të fundit. Duke marrë në konsideratë këtë fakt, rekomandohet që të bëhet një përditësim i tyre në përputhje me bazën ligjore të miratuar.

Sa i takon niveleve kufi të gjenerimit të zhurmave, në mjedise të brendshme dhe të jashtme, ato janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8/2007, për nivelet kufi të zhurmave<sup>4</sup>, si më poshtë:

<sup>4</sup> Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

Nr.	Mjedisi	Efekti kritik në shëndet	LA <sub>eq</sub> (dBA)	Koha bazë (orë)	L <sub>Amax</sub> Fast (dB)
<b>1</b>	<b>Zona banimi</b>				
1.1	Jashtë banese	Bezdi (shqetësim) serioze gjatë ditës dhe mbrëmjes	55	16	-
		Bezdi (shqetësim) i mesëm gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
1.2	Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e bisedës dhe (bezdi) shqetësim i moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
1.3	Në brendësi të dhomës së fjetjes	Prishja e gjumit natën	30	8	-
1.4	Jashtë dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashtë)	45	8	-
<b>2</b>	<b>Institucione</b>				
2.1	Klasa mësimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmëri e bisedës, vështirësi në kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjatë mësimit	-
2.2	Dhomat e fjetjes në kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
2.3	Oborri i shkollës, vendet e lojërave në shkollë	Bezdi (shqetësim) - (burime të jashtme)	55	Koha e pushimit	-
2.4	Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit natën Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30 30	8 16	40
2.5	Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim në pushim, çlodhje	# 1		
<b>3</b>	<b>Zona me aktivitetet social-ekonomik</b>				
3.1	Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
<b>4</b>	<b>Mjedis urban</b>				
4.1	Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
4.2	Ceremoni, festivale dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/vit)	100	4	110
4.3	Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85 # 4	1	110
4.4	Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarrët dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2 120#2
<b>5</b>	<b>Parqe publike</b>				
5.1	Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

**Tabela 2:** Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të brendshme dhe të jashtme

### **3.3. Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis (PKVMZM)**

*Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis i vitit 2010* është dokumenti i cili hap rrugën e zhvillimit të planeve lokale të zhvillimit, përgatitjen e hartave lokale të zhurmës dhe asaj kombëtare. Hartimi i planeve lokale të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis është një kërkesë që buron nga neni 8 të Ligjit 9774, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Plani kombëtar i veprimit të menaxhimit të zhurmës në mjedis (PKVMZM) është miratuar me **VKM Nr. 123, datë 17.02.2011, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”** dhe thekson domosdoshmërinë e zbatimit të standardeve evropiane për monitorimin e zhurmës, vlerave dhe metodologjive për monitorim dhe vlerësim të saj.

#### **3.1.1 Qëllimi Planit Kombëtar të Veprimit**

Nëpërmjet këtij plani veprimi synohet të behet një analizë e situatës aktuale, të përgjegjesive institucionale dhe të boshlleqeve ekzistuese ligjore dhe organizative si dhe të planifikohen masa të domosdoshme me afatë dhe buxhet të përcaktuar për tu ndermarre me qëllim përmbushjen e detyrimeve në kuadër të ligjit për administrimin mjedisor të zhurmave, të kërkesave të direktivave baze të Bashkimit Europian për zhurmat dhe të kërkesave të direktivave specifike që lidhen me këto çështje.

Ky dokument do të shërbejë gjithashtu për ministrinë, njësitet e qeverisjes vendore, strukturat e planifikimit dhe të vendimmarrjes që të marrin në konsideratë dhe të integrojnë në planin e tyre kërkesat specifike të përcaktuara në hartat e zhurmave dhe në planin lokal të veprimit për zhurmat.

#### **3.1.2 Objektiva kryesore të Planit Kombëtar të Veprimit**

- Përcaktimi i burimeve që gjenerojnë zhurmë të cilat paraqesin shqetësim për mjedisin dhe shëndetin e njerezve;
- Vlerësimi i shkallës së ndikimit në secilin burim;
- Vlerësimi i kuadrit ligjor rregullator i burimeve që gjenerojnë zhurmë;
- Aanaliza e përgjegjesive institucionale dhe kërkesa për përmirësime të metejshme;
- Politikat e BE-së për zhurmat dhe implementimi i tyre në legjislacionin kombëtar;
- Përllogaritja e kostos së përafërt për implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Zhurmat;
- Konkluzione dhe rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis;

### **3.4. Strukturat kryesore përgjegjëse për administrimin e zhurmës në mjedis**

Institucionet përgjegjëse dhe veprimtaritë e tyre për menaxhimin dhe parandalimin e ndotjes nga zhurmat në mjedis, janë si vijon:

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, nëpërmjet përcaktimit të niveleve kufi dhe zbatimit të masave mbrojtëse.
- **Ministritë e linjës** janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat synojnë menaxhimin e zhurmës në mjedis.
- **Këshilli Teknik për Zhurmat (KTZH)** pranë ministrit si organizëm ndërinstitucional këshillimor për çështjet e zhurmës.
- **Instituti i Shëndetit Publik** është institucioni bazë i cili shërben si referencë për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e saj.
- **Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë)**

Pavarësisht se kuadri ligjor dhe institucional është i përcaktuar qartë, sa i takon menaxhimin dhe administrimin e zhurmave hasen disa sfida kryesore, të tilla si:

- mungesa e hartimit dhe zbatimit të planeve të veprimit të zhurmave në mjedis në nivel kombëtar dhe lokal,
- moszbatimi i standardeve të OBSH-së dhe BE-së për vlerat kufi të zhurmës në mjedis, kryesisht zonat urbane,
- mungesa e konsolidimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve evropiane,
- zbatimi i legjislacionit mbi menaxhimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis dhe burimet kryesore të saj,
- forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional mbi menaxhimin e zhurmës në mjedis dhe integrimi i çështjes në politika e plane sektoriale,

### **3.5. Roli dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore në menaxhimin e zhurmave**

Pushteti vendor duhet të beje monitorime të vazhdueshme të zhurmave në terren, duke përcaktuar zonat me të ndjeshme në bashkitë Himare gjatë sezonit turistik. Mbledhja e të dhënave dhe krahasimi me vlerat e lejuara të përcaktuara në legjislacionin Shqiptar dhe direktivat e BE. Gjithashtu duhet të behen raportime të vazhdueshme dhe të hartohen plane menaxhimi për zbutjen e këtyre efekteve në bashkëpunim me bizneset dhe komunitetin.

**Referuar ligjit Nr.9774, datë 12.7.2007<sup>5</sup> për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis organet e qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre kanë këto përgjegjësi:**


---

<sup>5</sup> <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/Ligji-9774-dt.12.07.07-p%C3%ABr-zhurmat.pdf>

- Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive/komunave.
- Drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës brenda territorit të tyre.
- Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.
- Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.
- U kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.

#### 4. METODOLOGJIA MBI IDENTIFIKIMIN DHE MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË HIMARË

Për identifikimin dhe monitorimin e zhurmave në bashkinë Himarë është përdorur metodologjia e cila shpjegohet në skemën e mëposhtme.



**Figura 2:** Skema e metodologjisë së zbatuar për identifikimin dhe monitorimin e zhurmave



## 4.1 Hapat per identifikimin e zonave problematike ne bashkine Himarë.

### 4.1.1 Hulumtimi mbi perceptimin e komuniteteve lokale, bizneseve dhe pushtetit vendor mbi nivelin e zhurmave

Për të kuptuar dhe analizuar perceptimin e komuniteteve lokale, bizneseve dhe pushtetit vendor mbi zonat problematike ndaj zhurmave janë realizuar pyetësorë në bashkinë Himarë. Në total në bashkinë e Himarë janë plotësuar dhe analizuar **500 pyetësorë**. Nëpërmjet pyetësorëve të hartuar u siguruan të dhëna mbi zonat më të ekspozuara ndaj zhurmës gjatë sezonit të verës dhe pjesës tjetër të vitit.

Plotësimi i pyetësorëve në Bashkinë Himarë u realizua përgjatë muajve Nëntor - Dhjetor 2021. Anketimi kishte në fokus target grupin e qytetarëve mbi 15 vjeç. Duke ju referuar këtij fakti, target grupi i pyetur ka një shpërndarje të larmishme nga 15- 88 vjeç në bashkinë Himarë. Zgjedhja e të anketuarve ka qenë rastësore duke sjellë që rezultatet e pyetësorëve të jenë objektive dhe të besueshëm. Plotësimi i pyetsorit është realizuar në terren duke u fokusuar në lagjet dhe rrugët kryesore si dhe pranë institucioneve arsimore dhe vendore.



**Figura 3:** Foto gjatë plotësimit të pyetësorëve në bashkinë Himarë

### 4.1.2 Realizimi i takimeve me grupe nga komunitetet lokale dhe bizneset për të kuptuar problematikat që lidhen me zhurmat

Në datat **23 Dhjetor 2021** dhe **27 Janar 2022** u realizuan takimet në bashkinë e Himarës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatës lider Milieukontakt Albania dhe të organizatave partnere Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit dhe Gjelbërimi 2000, përfaqësues nga OJF lokale, përfaqësues të bashkisë Himarë, studentë, si dhe biznese lokale të zonës. Qëllimi i takimeve ishte evidentimi i zonave më problematike përsa i përket ndotjes akustike në bashkinë e Himarës. Gjatë diskutimit me pjesëmarrësit u evidentuan disa nga burimet kryesore që shkaktojnë zhurmat në bashkinë e Himarës si: trafiku i makinave, muzika e lartë në bare dhe disko etj. Pjesëmarrësi u angazhuan në punë me grupe për përcaktimin e zonave problematike duke i përcaktuar ato nëpërmjet hartave të printuara.



**Figura 4:** Foto gjatë takimeve në bashkinë Himarë

#### 4.2 Metodologjia e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare

Monitorimi alternativ i zhurmës në mjedis ka për qëllim kryesor të **vlerësojë situatën e zhurmave në zonat bregdetare, të vlerësojë shkallën e ndikimit te komunitetet lokale dhe të krijojë një bazë të dhënash për të adresuar më mirë problematikat** në mënyrë që të ndërtohet një plan masash efikase për të përmirësuar situatën në zonat problematike.

Monitorimi alternativ u përqendrua kryesisht në monitorimin e zhurmës në **zonat bregdetare më problematike** dhe do të konsistojë në monitorimin e zhurmave të vazhdueshme, duke përdorur parametrin *LAeq*, pasi zhurmat në këto zona janë të tilla. Monitorimi u kryhet fillimisht nga ekspertët e angazhuar në projekt dhe më pas përfaqësues nga komunitetet lokale të cilët u trajnuan mbi realizimin e monitorimit të zhurmave. Për realizimin e matjeve në bashkinë Himarë u angazhuan 2 aktivistë lokalë por dhe vullnetarë .

Monitorimi alternativ i zhurmës u realizua **në mënyrë manuale** (jo me stacione automatike të monitorimit të zhurmës) nëpërmjet pajisjes zhurmë-matëse **Enno Logic eS528L**.<sup>6</sup> EnnoLogic eS528L është një matës profesional i nivelit të zhurmave që siguron matje në një interval prej 30 deri në 130 dBA me një saktësi prej  $\pm 1,5$ dB. Nëpërmjet këtij matësi mund të regjistrohen vlerat maksimale dhe minimale të nivelit të zhurmave. Ky instrument shëben për të matur dhe regjistruar nivelet e zhurmës në zyra, fabrika, në lagje ose në shtëpi.

Monitorimi i zhurmave u realizua përgjatë muajve **Gusht dhe Shtator 2022**. Për secilin prej muajve u realizuan matjet e nivelit të zhurmave gjatë ditëve të javës si dhe gjatë fundjavës në orare të paracaktuara me qëllim që të bëhej një krahasim ndërmjet ditëve por edhe orareve të cilat ishin më problematike.


Të gjitha të dhënat e monitoruara për zhurmën do të paraqiten nëpërmjet hartave të realizuara nga aplikacioni GIS. Hartat do të gjenerohen për bashkinë Himarë dhe do të evidentojnë zonat me nivelet më të larta dhe më të ulta të ndotjes nga zhurmat.

<sup>6</sup> Aneks III. Pajisja e përdorur për monitorimin e zhurmave në bashkinë Himarë

<b>Metodologjia e monitorimit të zhurmave</b>  (36 stacione monitorimi në Himarë)	<b>Muaji Gusht</b>	Gjatë ditëve të javës	Paradite (ora 10:00-12:00)
		Gjatë fundjavës	Darkë (ora 20:00-24:00)
	<b>Muaji Shtator</b>	Gjatë ditëve të javës	Paradite (ora 10:00-12:00)
		Gjatë fundjavës	Darkë (ora 20:00-24:00)

**Tabela 3:** Metodologjia e monitorimit të zhurmavë në Bashkinë Himarë **Skema e përgjithshme e monitorimit manual të zhurmës në mjedis**

Proçesi i monitorimit të zhurmave në bashkinë e targetuar do të realizohet sipas skemës së mëposhtme:



**Figura 5:** Skema e monitorimit alternativ të zhurmave në zonat bregdetare

## 5. PERCEPTIMI QYTETAR MBI NIVELIN E ZHURMAVE NE BASHKINË HIMARË

### 5.1 Rezultatet nga pyetësorët e zhvilluar me qytetarët në Bashkinë Himarë

Bazuar ne analizimin e pyetësorëve të realizuar nga qytetarët në bashkinë e Himarës ka rezultuar:


- Vërehet një mungesë informacioni e qytetarëve për nivelin e zhurmave në zonat ku ata banojnë , ku 56% e tyre janë shprehur se nuk janë të informuar mbi nivelin e zhurmave.
- Për sa i përket ekspozimit nga zhurmat, rezulton se 18.5% e të anketuarve janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **shpesh**, 36.5% e të anketuarve janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **ndonjëhere**, 31.4% e të anketuarve janë shprehur se janë të ekspozuar ndaj zhurmave **rrallë** dhe vetem 13.1% e tyre nuk e konsiderojnë veten të ekspozuar ndaj zhurmave.
- Intervalet kohore më të zhurmshme kanë rezultuar gjatë pasdites (mesditë –18:00), ku rreth (38%) e individëve i perceptojnë burimet e zhurmes gjatë këtij intervali, dhe mbrëmja (18:00 – 00:00) ku (33%) e të pyeturve janë përgjigjur gjithashtu se gjatë këtij harku kohor ka zhurmë. Vetëm 11% e të anketuarve shprehen se nuk ka zhurmë gjatë 24 orëve.
- Për sa i përket fekteve të zhurmës tek individët ka rezultuar se, 35% e qytetarëve pohuan se ndiejnë zemërim, 31% prej tyre ndiheshin shumë të shqetësuar, 21% prej tyre ndiheshin të paprekur dhe 27% prej tyre ndiheshin të frustruar.
- Shumica e të intervistuarve (75%) e konsideronin zhurmën jo vetëm si një problem që shkakton bezdisje, por dhe besonin se ekspozimi ndaj saj mund të shkaktojë ose përkeqësojë gjendjen shëndetësore.
- Për sa i përket shpeshësisë së ekspozimit ndaj zhurmës, 53% të tyre pohuan se shpeshësia e zhurmës nuk ka pësuar ndryshim ndërsa për 34% të tyre ajo është ulur. Vetëm 13% e të anketuarve tani dëgjojnë më shpesh zhurmë.
- Në lidhje me shqetësimin e perceptuar për shkak të burimeve të zhurmës së lëvizshme 86.9% e të intervistuarve deklaruan se janë të shqetësuar nga të paktën një lloj burimi. Vihet re se ndotësi më i madh për sa i përket zhurmave është transporti rrugor me 53% dhe si pasojë boritë e automjeteve me 27%. Gjithashtu ndërtimet zënë një vlerë prej 47%, ndërsa bizneset (bare/klube, restorante, dyqane) që luajnë muzikë me zë të lartë zënë vetëm 19%.
- Referuar vendimeve dhe rregullorëve të hartuara dhe të miratuara nga bashkia Himarë, 27% e të anketuarve janë në djeni se ka një rregullore nga bashkia Himarë mbi ndotjen akustike dhe 73% e tyre nuk e njohin këtë fakt.
- Sipas perceptimit të qytetarëve, roli i medias në raportimin e gjendjes së ndotjes nga zhurmat ishte i ulët.
- Për sa i përket rolit të institucioneve në zgjidhjen e problematikave mbi nivelin e zhurmave, rezulton se (50%) e të anketuarve janë ankuar pranë Bashkisë Himarë dhe (42.7%) pranë Policisë së Shtetit. Më pak janë ankuar pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Mediave vizive dhe atyre të shkruara.

- Përgjatë sezonit të verës sipas qytetarëve zona më e zhurmshme ka qenë Spile (43%), Qendër (20%) dhe më pak zona e shëtitorës dhe plazhit (9%). Duke qenë se njerëz të ndryshëm përgjigjen ndryshe ndaj stimulit të zhurmës, 11% e qytetarëve nuk ndiejnë shqetësim. Përgjatë pjesës tjetër të vitit, jashtë sezonit të verës 55% e qytetarëve shprehen se nuk ka ndotje akustike, 13% mendojnë se Qendra gjeneron ndotje dhe 16% mendojnë për zonën e Spilesë.

## **5.2 Rezultatet nga workshopet e zhvilluara me grupet e interesit**

Zonat e evidentuara si problematike përsa i përket nivelit të zhurmave në Bashkinë Himarë janë si më poshtë vijon:

- **Zona e Livadhit**
- **Zona e Dhërmiut**
- **Zona e shëtitorës së qytetit**
- **Zona e plazhit**
- **Zona e Spilesë**



**Figura 6:**Harta e zonave të evidetuara si problematike për nivelet e zhurmave në Bashkinë Himarë


## 6. VLERËSIMI I NIVELIT TË ZHURMAVE DHE HARTËZIMI I TYRE NË BASHKINË HIMARË

### 6.1. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Gusht 2022

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 36 stacionet e monitorimit në Bashkinë Himarë, **gjatë ditëve të javës** për muajin **Gusht 2022**<sup>7</sup> rezulton se:

**Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **79.65 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **50.05 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **62.95 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.

- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **81.3 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **51.6 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **66.08 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë vlerën standate prej **45 dB** gjatë darkës.




**Figura 7:** Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2022)

<sup>7</sup> Aneks I. Hartat e ndotjes akustike gjatë ditëve të javës për muajin Gusht 2022, Bashkia Himarë

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit të zhurmave për 36 stacionet e monitorimit në Bashkinë Himarë, **gjatë fundjavës për muajin Gusht 2022<sup>8</sup>** rezulton se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **81.15 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **52.15 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **64.48 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **84.45 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **53.5 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës vlera tejkalonë standartet prej 45 dB gjatë darkës. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **69.7 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë vlerën standate prej **45 dB** gjatë darkës.



**Figura 8:** Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Gusht 2022)


<sup>8</sup> Aneks I. Hartat e ndotjes akustike **gjatë fundjavës për muajin Gusht 2022**, Bashkia Himarë



## 6.2. Rezultatet e monitorimit të zhurmave gjatë muajit Shtator 2022

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 36 stacionet e monitorimit në Bashkinë Himarë, **gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2022<sup>9</sup>** rezulton se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **79.35 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **50.1 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **63.7 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **83.05 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **52.6 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **67.26 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë vlerën standate prej **45 dB** gjatë darkës.




**Figura 9:** Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2022)

<sup>9</sup> Aneks I. Hartat e ndotjes akustike **gjatë ditëve të javës për muajin Shtator 2022**, Bashkia Himarë

Bazur në analizimin e të dhënave të grumbulluara të zhurmave për 36 stacionet e monitorimit në Bashkinë Himarë, **gjatë fundjavës** për muajin **Shtator 2022**<sup>10</sup> rezulton se:

- **Gjatë orareve të paradites (10:00 – 12:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **82.7 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **52.2 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **65.1 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë ditës vlera maksimale dhe vlera mesatare tejkalojnë standartin prej **55 dB** gjatë ditës.
- **Gjatë orareve të darkës (20:00 – 24:00)**, vlera maksimale e zhurmave është **85.7 dB** ndërsa vlera minimale e zhurmave është **51.6 dB**. Vlera mesatare për të gjithë stacionet e monitorimit është **70.3 dB**. Referuar normave të zhurmave gjatë natës këto vlera tejkalojnë vlerën standate prej **45 dB** gjatë darkës.



**Figura 10:** Niveli i zhurmave gjatë ditëve të javës paradite dhe darkë (Shtator 2022)

<sup>10</sup> Aneks I. Hartat e ndotjes akustike **gjatë fundjavës për muajin Shtator 2022**, Bashkia Himarë

## 7. KONKLUZIONE

- Nga anketimet rezulton se 98.7% e të anketuarëve janë shprehur së janë të ekspozuar ndaj zhurmave për një periudhë të gjatë ndersa 1.3% janë shprehur së zhurmat nuk përbëjnë një shqetësim për to.
- Sipas pyetësoreve ka rezultuar që intervalet kohore më nivelin më të lartë të zhurmave janë përgjatë periudhës së mesditës deri në orën 18:00 ku rreth 38% e individëve i janë te ekspozuar ndaj niveleve të larte të zhurmës dhe gjatë mbrëmjes (18:00 – 00:00) ku 33% e të pyeturve janë përgjigjur gjithashtu se gjatë këtij harku kohor ka nivele të larte të zhurmës. Vetëm 11% e të anketuarve shprehen se nuk ka nivele të larte të zhurmës gjatë 24 orëve.
- Rreth 75% e të intervistuarëve e konsiderojnë zhurmën jo vetëm si një problem që shkakton bezdisje, por janë të vetëdijshëm që ekspozimi ndaj saj mund të shkaktojë ose përkeqëson gjendjen shëndetësore.
- 53% e intervistuarëve pohuan se shpeshësia e zhurmës nuk ka pësuar ndryshim ndërsa për 34% të tyre ajo është ulur.
- 86.9% e të intervistuarëve deklaruan se janë të shqetësuar nga të paktën një lloj burimi. Burimi më i madh i gjenerimit të zhurmave është transporti rrugor me 53%, boritë e automjeteve me 27%. Gjithashtu ndërtime të zënë një vlerë prej 47%, ndërsa bizneset (bare/klube, restorante, dyqane) që luajnë muzikë me zë të lartë zënë vetëm 19% nga përgjigjet e të anketuarëve.
- Sipas përciptimit të qytetarëve, roli i medias në raportimin e gjendjes së ndotjes nga zhurmat është i ulët.
- 50% e të anketuarëve janë shprehur se janë ankuar pranë Bashkisë Himarë dhe 42.7% pranë Policisë së Shtetit. Më pak janë ankuar pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Mediave vizive dhe atyre të shkruara.
- Nga intervistat ka rezultuar që zona me nivelin më të lartë të zhurmave është Spile (43%) ndjekur nga Qendër (20%) dhe më pak zona e shëtitorës dhe plazhit (9%). Përgjatë pjesës tjetër të vitit, jashtë sezonit të verës 55% e qytetarëve shprehen se nuk ka ndotje akustike, 13% mendojnë se zona të Qendra gjeneron nivel të lartë të zhurmave dhe 16% mendojnë për zonën e Spilesë.
- Përgjatë ditëve të javës (muaji Gusht) gjatë orareve të paraditës (10:00-12:00) nga monitorimi vlera maksimale është 79.65 db (norma është 55 db).
- Përgjatë orareve të darkës (20:00-24:00) vlera maksimale e monitoruar është 81.3 db ndërsa vlera minimale është 51.6 db (norma gjatë natës është 45 db).
- Përgjatë fundjavës (muaji Gusht) gjatë orareve të paraditës (10:00-12:00) vlera maksimale është 81.15 db (norma është 55 db).
- Përgjatë orareve të darkës (20:00-24:00) vlera maksimale e monitoruar është 84.45 db ndërsa vlera minimale është 55.3 db (norma gjatë natës është 45 db).
- Përgjatë ditëve të javës (muaji Shtator) gjatë orareve të paraditës (10:00-12:00) vlera maksimale është 79.35 db (norma është 55 db).
- Përgjatë orareve të darkës (20:00-24:00) vlera maksimale e monitoruar është 83.05 db ndërsa vlera minimale është 52.6 db (norma gjatë natës është 45 db).
- Përgjatë fundjavës (muaji shtator) gjatë orareve të paraditës (10:00-12:00) vlera maksimale është 82.7 db (norma është 55 db).
- Përgjatë orareve të darkës (20:00-24:00) vlera maksimale e monitoruar është 85.7 db ndërsa vlera minimale është 51.6 db (norma gjatë natës është 45 db).

- Bashkia Himarë nuk ka bërë punë të mjaftueshme për të ndërgjegjësuar opinionin publik mbi mekanizmin e trajtimit të ankesave dhe shqetësimet e qytetarëve lidhur me zhurmat.

## 8. MASAT E PROPOZUARA PËR ELEMENIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS

Me qëllim menaxhimin e zhurmave janë propozuar një seri masash dhe aktorët përgjegjës për menaxhimin e tyre. Masat e propozuara adresojnë fuqizimin institucional të bashkisë dhe forcimit të ligjit që i detyron autoritetet lokale në një monitoim më të vazhdueshëm të nivelit të zhurmave. Përmisimi i infrastrukturës nëpërmjet vendosjes së sinjalistikës në vende të caktuara ku niveli i zhurmave është më i lartë dhe ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i komuniteteve për reduktimin e zhurmave.

Nr	Objektivi prioritar	Masat prioritare	Roli/përgjegjësia
1	Fuqizimi institucional i Bashkisë Himare për menaxhimin e zhurmave	Përcaktimi i një specialisti për mbështetje teknike në menaxhimin e zhurmave.	Drejtoria e mjedisit/ Drejtoria e burimeve njerëzore, Bashkia Himarë
		Trajnime të stafit të Bashkisë të cilët janë përgjegjës në kontrollin e zhurmës	Drejtoria e mjedisit/ Drejtoria e burimeve njerëzore, Bashkia Himarë
		Hartimi dhe funksionimi i mekanizmit të trajtimit të ankesave për zhurmat. Vendosja e një numri telefonik për të mbledhur ankesat dhe kontaktin përkatës.	Drejtoria Juridike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Ankimimeve, Bashkia Himarë
2	Zbatimi i ligjit dhe masave për kontrollin e zhurmës	Kontrolle të herë pas herëshme në mjedise të brendshme për nivelin e zhurmës (vecanerisht baret që përdorin muzikë në nivele mbi normat e lejuara për zhurmat në mjedise të mbyllura)	Policia Bashkiake/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë
		Këshillimi dhe penalizimi nga Policia Bashkiake në rast të reniës së borisë (pa shkak, në trafik) në zonat bregdetare dhe urbane.	Policia Bashkiake


3	Përmirësimi i infrastrukturës për reduktimin e zhurmave	Vendosja e sinjalistikës së nevojshme për kufizimin e shpejtësisë në rrugët dhe zonat më problematike	Drejtoria e Transportit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë
4	Ndërgjegjësimi dhe Sensibilizimi për reduktimin e zhurmave	Promovimi i masave për kontrollin e zhurmave në faqen elektronike të Bashkisë dhe në rrjetet sociale të Bashkisë.	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë
		Vendosja e tabelave elektronike sensibilizuese për nivelin e zhurmave, ndalimin e borive në zonat bregdetare.	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë
		Fushate sensibilizuese në media dhe terren për kufizimin e zhurmave gjatë sezonit turistik.	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë
		Fushata sensibilizimi në rrugë për shoferet me fletëpalosje për kufizimet e zhurmës (shpejtësisë, borisë, dëmet e zhurmës, penalitetet etj).	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë
		Edukimi dhe realizimi i fushatave të ndërgjegjesimit me nxënësit e shkollave për reduktimin e zhurmave.	Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun/ Drejtoria e mjedisit, Bashkia Himarë

# 9. ANEKS I. HARTAT E ZHURMAVE PËR BASHKINË HIMARË



## HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË DITËVE TË JAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA HIMARË)  
MUAJI GUSHT 2022






# HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË FUNDJAVËS

## ZONA BREGDETARE (BASHKIA HIMARË) MUAI GUSHT 2022

Financuar nga LevizAlbania



Projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim Shtetëror  
Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim Shtetëror






# HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË DITËVE TË JAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA HIMARË)  
MUAJI SHTATOR 2022

Partneri nga LevizAlbania



Është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillimin e Bashkëpunimit SDC  
Schweizer Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC









# HARTA E NDOTJES AKUSTIKE GJATË FUNDJAVËS

ZONA BREGDETARE (BASHKIA HIMARË)  
MUAJI SHTATOR 2022

Financuar nga Leviz Albania



Në përputhje me Agjencinë Evropiane për Zhvillimin Regional dhe Komunitetin Evropian



10. ANEKS II. STACIONET E MONITORIMIT PËR BASHKINË HIMARË



# 11. ANEKS III. PAJISJA E PËRDORUR PËR MONITORIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË HIMARË

